



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 29.09.2022

Nr. 198

**V E N D I M**

**P Ë R**

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË KOMITETIT PËRFAQËSUES TË NISMËS LIGJVËNËSE  
TË ZGJEDHËSVE, PËR MIRATIMIN E FLETËS TIP PËR MBLEDHJEN E  
NËNSHKRIMEVE, PËR PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT “PËR PËRCAKTIMIN E  
MINIMUMIT JETIK”**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 10 dhe nenit 13, pika 1, të ligjit nr. 54/2019 “Për nismën ligjvënese të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**V Ë R E N:**

Komiteti përfaqësues i nismës ligjvënese të zgjedhësve, i përbërë nga 8 (tetë) zgjedhës si vijon: zj. Anxhela Nasto, z. Arlind Qori, z. Jani Marka, zj. Mirela Ruko, zj. Geraldina Mançka, z. Redi Muçi, zj. Vitori Çipi dhe z. Xhuliano Bregasi, kanë paraqitur pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kërkesën nr. 3197 prot, datë 16.09.2022, për pajisje me fletë tip për nismën ligjvënese të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë, për propozimin e projektligjit “Për përcaktimin e minimumit jetik”.

Bashkëlidhur kërkesës, komiteti përfaqësues ka depozituar:

- Kopje të kartave të identitetit të përfaqësuesve të nismës;
- Projektligjin “Për përcaktimin e minimumit jetik”;
- Relacionin shpjegues të projektligjit.

Projektligji që do t’i propozohet Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, sipas kërkesës së komitetit përfaqësues, ka për qëllim të zbusë varfërinë dhe përjashtimin social për individët, familjet në nevojë dhe kategoritë e tjera përfituese të skemave të asistencës sociale duke përcaktuar nivelin e minimumit të nevojshëm për të siguruar kushtet bazë të jetesës.

Në zbatim të pikës 2, të nenit 10, të ligjit nr. 54/2019 “Për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të miratojë me vendim brenda 15 ditëve nga paraqitja e kërkesës, modelin e fletës tip të mbledhjes së nënshkrimeve dhe ta publikojë atë në faqen zyrtare të KQZ-së, në një format të shkarkueshëm.

Fleta tip e mbledhjes së nënshkrimeve, në njërën anë duhet të përmbajë informacion mbi nismën ligjvënëse që do t’i propozohet Kuvendit, qëllimin dhe një shpjegim të përmbledhur të saj si dhe të dhëna për përfaqësinë/komitetin përfaqësues të nismës. Në anën tjetër duhet të përmbajë: numrin rendor, gjenealitet e zgjedhësit që mbështet nismën, vendin dhe datën e lindjes, numrin e kartës së identitetit apo pasaportës së zgjedhësit, kolonën për nënshkrimet e zgjedhësve si dhe hapësirën përkatëse për emrin dhe mbiemrin e anëtarëve të grupit të mbledhjes së nënshkrimeve.

Referuar nenit 13, pika 1, të ligjit nr. 54/2019 “Për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, brenda 15 ditëve nga paraqitja e kërkesës me shkrim të përfaqësisë/komitetit përfaqësues të nismës për pajisjen me fletët tip për mbledhjen e nënshkrimeve, përcakton me vendim, sipas propozimit të përfaqësisë/komitetit përfaqësues, periudhën kohore gjatë të cilës zhvillohet procesi i mbledhjes së nënshkrimeve, në vendet publike dhe private, si dhe nënshkrimeve elektronike. Referuar kërkesës, periudha për mbledhjen e nënshkrimeve të zgjedhësve të kësaj nisme ligjvënëse, do të jetë 3 (tre) muaj nga data e hyrjes në fuqi të vendimit.

Kërkesa e komitetit përfaqësues të nismës ligjvënëse përmban informacion mbi nismën ligjvënëse që do t’i propozohet Kuvendit, qëllimin dhe shpjegimin në mënyrë të përmbledhur të saj si dhe të dhënat e komitetit përfaqësues të nismës.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 10 dhe nenit 13, pika 1, të ligjit nr. 54/2019 “Për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

## V E N D O S I:

1. Miratimin e fletës tip për mbledhjen e nënshkrimeve, sipas lidhjes që i bashkëlidhet këtij vendimi, dhe publikimin e saj në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
2. Procedura për mbledhjen e nënshkrimeve të zgjedhësve të realizohet brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

FLETË TIP PËR MBLEDHJEN E NËNSHKRIMEVE PËR NISMËN LIGJVËNËSE TË ZGJEDHËSVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, PËR PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT “PËR PËRCAKTIMIN E MINIMUMIT JETIK”

Nr.	Emri, Atësia, Mbiemri	Datëlindja (data, muaji, viti)	Vendlindja	Nr. i kartës së identitetit ose pasaportës	Nënshkrimi i zgjedhësit
1					
2					
3					
4					
5					
6					
7					
8					
9					
10					
11					
12					
13					
14					
15					
16					
17					
18					
19					
20					
21					
22					
23					
24					
25					

Grupi i mbledhjes së nënshkrimeve

(emër, mbiemër, firma)



Në mbështetje të nenit 81, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 54/2019 “Për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë”, Komiteti përfaqësues i nismës ligjvënëse, i përbërë nga 8 (tetë) zgjedhës si vijon: zj. Anxhela Nasto, z. Arlind Qorri, z. Jani Marka, zj. Mirela Ruko, zj. Geraldina Mançka, z. Redi Muçi, zj. Vitori Çipi dhe z. Xhuliano Bregasi, kërkon t’i propozohet Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, projektligji “Për përcaktimin e minimumit jetik”, i cili ka për qëllim të zbusë varfërinë dhe përjashtimin social për individët, familjet në nevojë dhe kategoritë e tjera përfituese të skemave të asistencës sociale duke përcaktuar nivelin e minimumit të nevojshëm për të siguruar kushtet bazë të jetesës. Ndërhyrja ligjore për përcaktimin e minimumit jetik vjen në të njëjtën linjë me Shtyllën Europiane të të Drejtave Sociale e cila përcakton se, *“Kushdo që ka burime të pamjaftueshme gëzon të drejtën për të përfituar të ardhura në nivel të përshtatshëm që sigurojnë jetesë me dinjitet në të gjitha fazat e jetës dhe akses efektiv në mallra dhe shërbime. Për pjesën ekonomikisht aktive, përfitimet e të ardhurave minimale duhet të kombinohen më nxitjet për (ri)integrimit në tregun e punës”*.

Përcaktimi i minimumit jetik është një e drejtë shoqërore themelore, e cila i shërben gjerësisht interesit të publikut dhe për pasojë gjen mbështetje të gjerë në shoqëri. Njohja me ligj e minimumit jetik nuk do të ndihmonte vetëm më të varfrit, por do të kishte efekt domino edhe te paga minimale dhe të gjitha pagat e tjera, duke shtuar mirëqenien dhe zgjeruar të drejtat.

Në këtë nismë ligjvënëse propozohet ky përkufizim për minimumin jetik: *“Minimumi jetik” është e drejta për të përfituar shumën monetare që garanton kushtet bazë të jetesës për një person ose familje që nuk ka ose ka pamjaftueshmëri të mjeteve të nevojshme për të plotësuar nevojat bazike.*

Teknikisht, në këtë ligj propozohet:

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit të miratojë metodologjinë e përlogaritjes së minimumit jetik, si dhe të miratojë vlerën që rezulton nga kjo metodologji.
2. Ngarkohet Këshilli i Ministrave për indeksimin e përvitshëm të vlerës së minimumit jetik.